Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Sahit Beqiri	**27.03.2024**	**06.04.2024**	**2024/0239**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **20.03.2024**, OE:**STANDARD HOME FURNITURE L.L.C.; - Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **2024/0239**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë GOE: **Lot :3Wood Corporation L.L.C.; Madekos Sh.p.k. - Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me mobilje"** me nr. të prokurimit: **"UA/2016-23-14297-1-1-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) **– Agjencia Qendrore e Prokruimit.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: **furnizim**, vlera e parashikuar e kontratës: **2,250,000.00 €**. Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë **NUK** është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankese)

Ligji për Prokurim Publik i konsoliduar

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi;

Neni 24 Zyrtarët e Prokurimit gjatë Ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit;

Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës;

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;

Neni 69 Kapaciteti teknik dhe profesional;

Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve.

Rregullorja nr. 001/2022, per Prokurim Publik

Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;

Neni 97 Shkeljet e Renda.

Udhezuesi për Prokurim Publik nr. 001/2023

Neni 10 Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve.

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet

Te nderuar,

Grupi i OE ankues Standard Home Furniture L.L.C, & NNP STANDARD PLUS me daten 11.03.2024, ne kuptim te nenit 108/A te LPP-se, ka parashtruar kerkese per rishqyrtim dhe ka kundershtuar vendimin mbi rezultatin e aktivitetit te prokutimit sa i perket propozimit per dhenie te kontrates ne lotin 3 "Furnizim me inventar shkollore" te aktivitetit te prokurimit me titull *Furnizim me mobilje*, me nr prokurimi: UA/2016-23-14297-1-1-1.

Autoriteti Kontraktues – Agjencia Qendrore e Prokurimit AQP, sipas vendimit te dates 14.03.2024, ka refuzuar kerkesen tone per ri shqyrtim dhe ka lene ne fuqi propozimin per dhenie te kontratës, perkunder faktit se ne si kompani kemi prezantuar prova dhe baze ligjore permes te ciles konfirmohet se eshte rekomanduar per dhenie te kontrates oferta e pa pergjegjeshme ne raport me kerkesat kualifikuese, prandaj ne kuptim te nenit 109, te LPP-se dhe ne afatin e parapare paraqesim kete:

A N K E S E

Pretendimi ankimor 1:

Autoriteti Kontraktues – Agjencia Qendrore e Prokurimit – AQP, sipas vendimit per refuzim te kerkeses ka konsumuar shkelje ligjore nga neni 108/A, te LPP-se, paragrafin 8, pika 4 dhe paragrafi 9 ku percaktohet:

*8. **Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur**:*

*8.4 **Autoriteti kontraktues ka shqyrtuar vendimin e tij në kuptimin e asaj që kërkohet nga ankuesi.***

Paragrafi 12 i nenit 108/A, te LPP-se:

*"Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, **duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj**,*

parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë".

Zyrtarja pergjegjese e prokurimit te AK – AQP, ka nxjerr vendim, perkatesisht pretendimet tona ankimore i ka deformuar dhe nuk i ka trajtuar ne formen e kerkuar nga ne si OE, rrjedhimisht i ka anashkaluar kerkesat e parqitura ne dosje te tenderit sa i perket deklarates per specifikacione teknike te detyrueshme.

Pretendimi ankimor 2:

Autoriteti Kontraktues –Agjencia Qendrore e Prokurimit, ne piken 3.1 te Dosjes se tenderit (FDT) ka aplikuar kerkese dhe atë si me poshte:

Pretendimi ankimor 2:

Autoriteti Kontraktues –Agjencia Qendrore e Prokurimit, ne piken 3.1 te Dosjes se tenderit (FDT) ka aplikuar kerkese dhe atë si me poshte: *"Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar tëkontratës, duke përfshirë:*

a. *Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit";*

Autoriteti Kontraktues – Agjencioni Qendror i Prokurimit, përkatësisht sipas vendimit dhe refuzimit te kerkeses sonë potencon se OE i rekomanduar për dhënie te kontratës "Wood Corporation LLC & Madekos" shpk, **kane nenshkruar dhe vulosur aneksin** 1 !

Aneksi 1 i dosjes se tenderti ligjerisht është kerkese zbatuese dhe implementuese e kontratës perkatesisht nuk është kerkese kualifikuese (shiqo nenin 28 te LPP-se). Kërkesë kualifikuese e përcaktuar nga AK – AQP, është deklarata për specifikacione teknike për mallerat e ofruara te cilat perputhen me ato te pershkruara ne aneksin 1 te dosjes.

- Deklarata e tille nuk është prezantuar ne oferte nga grupi i OE-ve te rekomanduar

a. **për dhënie te kontratës ne Lotin 3.**

Nenshkrimi dhe vulosja e aneksit 1 nuk e ben ofertën e pergjegjeshme ne raport me kerkesen kualifikuese. Pra, nuk është kerkuar nga ofertuesit qe te nenshkruhet aneksi 1 por është kerkuar qe te prezantohet DEKLARATE PËR SPECIFIKACIONE TEKNIKE TE DETYRUESHME.

Prove: Aneksi 1 i nenshkruar vetëm nga njeri anetar i grupit dhe e trajtuar si e mireqene nga AK – AQP.

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Sipas nenit 94 te Ligjit te Prokurimit Publik Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, ne kuadër te Ministrisë se Financave të Republikës së Kosovës është themeluar Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) .

AQP sipas Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës, është përgjegjëse për:

- ✓ Zhvillimin e prokurimeve të përbashkëta për Njësitë Kërkuese;
- ✓ Me kërkesën e Njësive Kërkuese, kryen aktivitetet e prokurimit ne emër te tyre; dhe
- ✓ Me kërkesën e Njësive Kërkuese, ndihmon në kryerjen e aktiviteteve të prokurimit.

Autoriteti Kontraktues (Agjencia Qendrore e Prokurimit) është duke identifikuar furnizuesit që do të kenë kapacitetin për të furnizuar me produkte inventarit për Autoritetet Kontraktuese të identifikuara në Aneksin 7. Furnizuesit do të jenë përgjegjës për menaxhimin e plotë të furnizimit për Autoritetet Kontraktuese të identifikuara në Aneksin 7.

Rreziku i humbjes apo dëmtimit, të produkteve të inventarit nga cilido shkak do të jetë mbi Furnizuesin dhe do te përballohet nga Furnizuesi deri ne kohen kur mallrat te dorëzohen në pronësi të AK. Produktet e dorëzuara nga kontraktori dhe të pranuara duhet të janë në përputhje me EN & ISO standardet mbi specifikacionet teknike.

AK te cilat janë te identifikuar në Aneksin 7 kane të drejtë të refuzojnë çdo dërgesë e cila dështon në përmbushjen e specifikimeve minimale të cilësisë të përcaktuara në ketë specifikim teknik.

Agjencia Qendrore e Prokurimit pas nënshkrimit te kontratës do te shpërndaje nga një kopje te nënshkruar te kontratës tek secili Autoritet Kontraktues i identifikuar ne Aneksin 7. Një kopje e kontratës se nënshkruar do te publikohet ne webfaqen e AQP-se.

Furnizuesi do të emërojë një përfaqësues, i cili do të veprojë si pikë kontaktuese e Furnizuesit për të gjitha çështjet që lidhen me kontratën. Ky përfaqësues apo zëvendësi i tij do të ketë autoritetin e duhur për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhë çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës.

Çdo AK i specifikuar ne Aneksin 7 do të emërojë një përfaqësues si pikë ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe OE i cili do të ketë autoritetin për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhë çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës.

Garancioni për secilin artikull është 12 muaj nga pranimi i mallit.

Devijimi i lejuar në dimension është +- 5 % si për tavolina, dollapë dhe karriga zyrtare. Inventari duhet të jetë komfor specifikimeve teknike të specifikuara më poshtë dhe komfor standardeve.

Fotot janë vetëm për ilustrim, obligative është të plotësohet kërkesat e paraqitura tek "përshkrimi"

WOOD CORPORATION LIMITED LIABILITY COMPANIES

OSHP, përkatësisht eksperti\ja shqyrtues/s për konsistence ne vendosje mund ti referohet vendimit te nxjerre nga Paneli Shqyrtues me nr. **484-486/23.**

<u>Pretendimi ankimore nr. 3</u>

AK Agjencioni Qendror i Prokurimit, tek kerkesat mbi mundesit teknike dhe profesionale nga pika 9.1 & 9.2 ne pozicionin 1, ka kerkuar: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses **furnizime tënatyrës se ngjajshme në 3 (tri) vitet e shkuara**, jo me pak se Lot **1 200,000.00** Euro Lot 2 700,000.00 Euro **Lot 3 3,000,000.00 Euro.**

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Operatori Ekonomik duhet te plotësoj formularin standard të dhënë në Aneksin 8 te Dosjes se Tenderit apo ndonjë format tjetër që përfshinë afërsisht te dhënat e aneksit 8 dhe te bashkëngjis certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton liferimin e tillë,

gjithashtu Operatori Ekonomik për plotësimin e kësaj kërkesë mund te bashkëngjisë edhe Listë Libër të faturave të shitjeve (ku duhet të shihet qartë të paktën blerësi, data, artikujt dhe shuma duke ua bashkangjitur faturat si dëshmi) apo edhe duke paraqitur referenca si nga blerësi publik apo edhe nga blerësi privat".

Grupi i OE-ve te rekomanduar për dhënie te kontratës ne 2 lote, perkatesisht ne lotin 1 dhe 3, për tu kualifikuar si te pergjegjeshem për te dy lotet do duhej te prezantonin projekte te realizuara ne vlere prej **4,200,000.00€**

Sipas deshmive te prezantuara ne oferte ne emer te liderit te grupit është prezantuar lista e projekteve dhe atë ne vlere prej 1,460,860.47, por nuk janë prezantuar dëshmi dokumentare përmes te cilave vertetohet se për periudhen e shkuar 3 vjecare eshte permbushur e njejta vlere.

Anetari tjetër i grupit "Madekos"shpk, si deshmi ka prezantuar referenca për furnizime dhe sherbime për produkte dhe paisje mediscinale, projekte këto te cilat nuk kane kurrefar lidhje me projekte te ngjashme me natyren e aktivitetit te prokurimit.

- Materiali medicinal, penje kirurgjik, pajisjet mjekesore elektronike, barnat, reagencat dhe produktet tjera mjekesore nuk kane te bëjnë me këtë procedur te prokurimit.

Kontratat e lidhura pergjate vitit 2019 dhe 2020, janë kontrata te cilat nuk korespodojne me periudhen kohore te kontraktuar. AK – AQP, nuk ka ekzaminuar, nuk ka krahasuar dhe nuk i ka vleresuar deshmit ne raport me kerkesat e percaktuara ne dosje te tenderit dhe njoftim për kontrate.

Prove: dëshmitë te cilat tregojne se janë pranuar projekte te realizuara pergjate vitit 2020, e te cilat janë trajtuar si te mireqena.

TEB

Receipt

Date : 11/03/2020
No : 00001261

Account No:20-25-0001670765-05
Sender:130000100102495 6
Beneficiary:WOOD CORPORATION L L C

TAFIL ORACA BI TAFIL ORACA BI PAGESE TE FATURES NR 7 PER W EUR 30,000.00+
Value : 11/03/20

WOOD CORPORATION LLC

TAFIL ORACA BI PAGESE TE FATURES NR 7 PE
WOOD CORPORATION L L C

EUR.30,000.00 credited to your account.

- 811289562

For Supp.Info:
(038) 23 00 00

Regards,
THERANDA BRANCH

Approved electronically.

TEB S.H.A.
01 NOV 2021
Therandë City Office

Receipt

Date : 07/12/2020
No : 00001431

Account No:20-25-0001670765-05
Sender:130000100102495 6
Beneficiary:WOOD CORPORATION LLC

TAFIL ORACA BI TAFIL ORACA BI PAG E FAT NR 34 /WOOD CORPOR EUR 10,000.00+
Value : 07/12/20

WOOD CORPORATION LLC

TAFIL ORACA BI PAG E FAT NR 34 /WOOD
CORPORATION LLC

EUR.10,000.00 credited to your account.

- 811289562

For Supp.Info:
(038) 23 00 00

Regards,
THERANDA BRANCH

Approved electronically.

TEB S.H.A.
01 NOV 2021
Therandë City Office

Provat e sipërprezantuara tregojne se AK AQP, ka pranuar projekte te cilat janë kontraktuar dhe janë realizuar pergjate vitit 2020, periudhe kjo e cila nuk korrespondon me kerkesen e Autoritetit Kontraktues, përkatësisht për periudhen e shkuar tre vitet e fundit. Kontrata është e lidhur me datën 05/03/2020, e njejta është realizuar pergjate te njejtit vit dhe referenca e prezantuar për këtë projekt permban datën 2021 dhe AK e ka trajtuar si te mireqene. Rrjedhimisht AK për projekte si kjo detyrimisht ka qene dashur te kërkojë sqarim shtese përgjate procesit te vleresimit te ofertave, madje edhe t'i konfirmoje referencat e prezantuara

ne oferte sa i përket vertetesise se tyre.

Ngjashëm është vepruar edhe me kontrata dhe projekte tjera te cilat janë realizuar jashta periudhes kohore te përcaktuar nga AK. Pra lideri i grupit te OE te rekomanduar për dhënie te kontratës ne lot 1 dhe 3 sipas deshmive te prezantuara ne oferte nuk e mbulon vlerën e përcaktuar nga AK, madje as edhe për Lotin 1.

Pretendimi ankimore nr. 4.

Autoriteti Kontraktues Agjencia Qendrore e Prokurimit tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1 & 9.2, e FDT-se, ne pozicionin 2 ka kerkuar: *Katalogu për produktet qe oferton*",

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- *Katalogu për produktet qe oferton* - ***Katalogu duhet të jetë i sakët për produktet që ofertoni. Nuk lejohet të ketë opsionie si minimum apo duhet të ketë..., pra nuk mund të shfrytëzohet Aneksi 1 i dosjes së tenderit si katalog por duhet të ofrohet katalog që përfshinë të gjitha specifikat e produktit të cilin e ofroni***.

Pra AK - AQP, ne kerkesekualifikuese ka përcaktuar qe OE duhet te prezantoj katalog te sakt dhe se nuk lejohet dhenuk mund te shfrytezohet aneksi 1 i dosjes se tenderit.

Grupi i OE-ve te rekomanduar ne lotin 3 pikerisht e kane bere një gje te tille kane marre pershkrimin nga aneksi 1 i dosjes se tenderit dhe kane krijuar broshure me pershkrim te sakt nga aneksi 1 i dosjes se tenderit.

10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve.

Problemi	**Si të veprohet**	**Neni i LPP-së**
Dëshmitë mbi gjendjen ekonomike dhe financiare nuk përmbushin kërkesat minimale	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	68
Mungon specifikacioni Teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu (specifikimit teknik	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshë	28

Bazuar ne provat dhe faktet e prezantuara si me larte, grupi i OE ankues Standard Home Furniture L.L.C & NNP STANDARD PLUS konsideron se AK - AQP, vlerësimin krahasimin dhe ekzaminimin e ofertave e ka realizuar ne kundërshtim me ligjin për prokurim public dhe me aktet tjera nënligjore, prandaj propozojmë qe eksperti shqyrtues ne kuptim te dispozitave te

nenit 113 te LPP-se, të trajtoje pretendimet tona ankimore ne kuptim te asaj se cfare ne kemi kerkuar, ne mënyrë qe paneli shqyrtues te nxjerre këtë:

V E N D I M

- **Te aprovohet** si e bazuar, ne tërësi ankesa e Grupit të OE Standard Home Furniture L.L.C & NNP STANDARD PLUS,

- **Te kthehet lënda ne Rivlerësim** dhe te rekomandohet për dhënie te kontratës OE ankues,

- **Te obligohet** AK AQP, qe gjatë ri vlerësimit e ofertave ti respektoj ne tërësi dispozitat ligjore.

- **Te lejohet kthimi i mjeteve** te deponuara ne emer te ankeses.

Pretendimet ankimore (dispozitat e shkelura nga AK), nuk janë të njëjta me kërkesa për rishqyrtim në autoritetin kontraktues (pasi qe OE ankues ka shtuar nenin 24, 52, 69, 108/A, te LPP-se, nenin 40 dhe 97 te Rregullores Nr. 001/2022 për PP si dhe nenin 10 Udhëzuesit Nr. 001/2023 për PP, ndërsa ka larguar nenin 1, 6, nenin 60), kurse tek Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet – nuk janë te njëjta me atë të dorëzuar në kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së duke plotësuar dhe ndryshuar, andaj bazuar ne nenin 64.2 te Rregullores Nr. 001/2022 për PP, si neni 13 par. 9 i Rregullores së OSHP-së Nr. 01/2020, në të cilën thuhet: *"Ankesat duhet të jenë të qarta, e shkurtër, dhe me pretendimet e supozuara që eventualisht janë shkelur nenet e caktuara të LPP-së nga ana e Autoritetit Kontraktues. Pretendimet ankimore parimisht duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në Autoritetin Kontraktues"*

KRITERET PËR VLERËSIM

(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe/apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore)

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional **Dëshmia e kërkuar dokumentar.**

Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses furnizime të natyrës se ngjajshme në 3 (tri) vitet e shkuara, jo me pak se Lot 1 200,000.00 Euro Lot 2 700,000.00 Euro Lot 3 3,000,000.00 Euro	**Dëshmia 1 Operatori Ekonomik duhet te plotësoj formularin standard të dhënë në Aneksin 8 te Dosjes se Tenderit apo ndonjë format tjetër që përfshinë afërsisht te dhënat e aneksit 8 dhe te bashkëngjis certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton liferimin e tillë, gjithashtu Operatori Ekonomik për plotësimin e kësaj kërkesë mund te bashkëngjisë edhe Listë Libër të faturave të shitjeve (ku duhet të shihet qartë të paktën blerësi, data, artikujt dhe shuma duke ua bashkangjitur faturat si dëshmi) apo edhe duke paraqitur referenca si nga blerësi publik apo**

	edhe nga blerësi privat.
Kërkesa 2 Katalogu për produktet qe oferton	**Dëshmia 2 Katalogu për produktet qe oferton - Katalogu duhet të jetë i sakët për produktet që ofertoni. Nuk lejohet të ketë opsionie si minimum apo duhet të ketë... , pra nuk mund të shfrytëzohet Aneksi 1 i dosjes së tenderit si katalog por duhet të ofrohet katalog që përfshinë të gjitha specifikat e produktit të cilin e ofroni.**

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Garancioni për secilin artikull është 12 muaj nga pranimi i mallit.

Devijimi i lejuar në dimension është +- 5 % si për tavolina, dollapë dhe karriga zyrtare. Inventari duhet të jetë komfor specifikimeve teknike të specifikuara më poshtë dhe komfor standardeve.

Fotot janë vetëm për ilustrim, obligative është të plotësohet kërkesat e paraqitura tek "përshkrimi"

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues/ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Grup i Operatorëve Ekonomik STANDARD HOME FURNITURE L.L.C.; Dashmir Limaj, ka plotësuar të gjitha kërkesat të parashtruara në dosje të tenderit dhe njoftim për kontratë, Lot 1, Lot 2 dhe Lot 3, mirëpo meqë , nuk kanë qenë oferta të përgjegjshme me çmimin më të ulët, nuk janë rekomanduar për kontratë.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

(Të jepet një vlerësim se OE ankues **nuk është** pale me interes sipas nenit **4.1.26 të LPP-së)**

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **STANDARD HOME FURNITURE L.L.C.**

(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe/apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore)

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimet OE ankues Nr. 1

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 7, 24, 52, 59,69, 108/A të LPP-së, nenin 40 dhe 97 te Rregullores Nr. 001/2022 për PP, nenin 10 te Udhëzuesit për PP Nr. 001/2023 si dhe deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet lidhur me këtë ankese për këtë aktivitet te prokurimit.

Gjithashtu, duke u bazuar ne analizën dhe rrjedhën lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, eksperti shqyrtues e sheh si palë pa interes juridiko material, konform **nenit 4 par. 1.26 të LPP-së**, ku thotë, po citoj: "***Palë e interesuar*** - *personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar*". Gjitahstu, duke marr për bazë edhe *Njoftim për Operatorët Ekonomik* nga OSHP të datës 09.02.2023 në pajtim me *pikën b)* të këtij njoftimi, pasi që OE ankues nuk ka ngritur asnjë pretendim lidhur me GOE: *Prime Corporation L.L.C. & Erzeni Sh.p.k.,* bazuar ne raportin e vlerësimit të datës 11.03.2024 te cilët kanë tenderuar me çmimin më të ulët se sa OE ankues dhe shpallur OE te përgjegjshëm – pasuksesshëm nga AK. Prandaj, në bazë të analizës se mësipërme sqarojë se pretendimet e palës ne ankese **nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues.**

Gjithashtu, ESH sqaron se bazuar ne **nenin 64.2 te Rregullores Nr. 001/2022 për PP, si neni 13 par. 9 i Rregullores së OSHP-së Nr. 01/2020**, në të cilën thuhet: "*Ankesat duhet të jenë të qarta, e shkurtër, dhe me pretendimet e supozuara që eventualisht janë shkelur nenet e caktuara të LPP-së nga ana e Autoritetit Kontraktues. Pretendimet ankimore parimisht duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në Autoritetin Kontraktues" , pretendimet e GOE ankues janë ne kundërshtim me këto dispozita si më larë.*

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që

fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe të gjeturat tjera në këtë raport, eksperti shqyrtues ipropozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të ***refuzohet si e pa bazuara*** *(për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimin nr. 1), dhe të njëjtin tender për* **Lot 3** *rekomandojmë që të* ***mbete në fuqi vendimi i AK*** *lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.*

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Agjencia Qendrore e Prokruimit**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **STANDARD HOME FURNITURE L.L.C.**

Sahit Beqiri